



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 54 Prot.

Tiranë më 08.02.2019

URDHËR

Nr. 8 Datë 08.02.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të Ligjit 10 093, datë 09.03.2009 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile"; nenit 26 të Ligjit Nr. 90/ 2012 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore"; nenit 28 dhe 29 të Ligjit Nr. 44/ 2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar);

Për arsye të angazhimeve Institucionale të Titullarit dhe pamundësisë së prezencës së Tij pranë zyrave:

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile z. Erion BANUSHIT- Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit të Projekteve;
2. Kompetencat e deleguara të titullarit do të ushtrohen përgjatë periudhës 11.02.2019 deri në datën 15.02.2019 duke përfshirë edhe kompetencën e Nëpunësit Autorizues të Institucionit për veprimet pranë Degës së Thesarit- Tiranë;
3. Nuk delegohen kompetencat e Titullarit lidhur me personelin si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;
4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij Urdhri, Përgjegjësi i Sektorit të Zhvillimit të Projekteve, do të ruajë kopje të praktikave shkresore të inicuar apo të përfunduara prej tij dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve do t'ia bëjë të ditura Titullarit me rikthimin e tij në detyrë;
5. Ngarkohet z. Erion Banushi për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI EKZEKUTIV


Andi KANANAJ

Adresa: Rr. "Frosina Plaku" Nr.58, Kati 2, Godina e Observatorit, Tiranë, Shqipëri.
website: www.amshe.gov.al E-mail: info@amshe.gov.al

